

VENDIM
Nr. 998, datë 9.12.2015

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS NR. 5, LOTI 2 DHE 3, SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nr. 5, loti 2 dhe 3, Sarandë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Sarandë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 55 638 387 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2015.
5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Sarandë.
7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E PASURIVEQËSHPRONËSOHENQËPREKENNGAZBATIMI I PROJEKTTIT
"NDËRTIMI I RRUGËSTË 5-TË, LOTI II DHE III, SARANDË"

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqia		Çmimi		Vlera		Shenime
	Emri	Mbiemri				Truall m²	Ndërtim m²	Truall lekë	Ndërtim lekë	Truall lekë	Ndërtim lekë	
1	RUSTEM	SHEHAJ	86421.3	11/168	Banesc	309	398	10777	82395	3330093	29136719	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	LEVENT	ÇATO	86421.3	11/134	Banesc	151	43	10777	situacion	1626680	324054	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	AGRON	KASO	86421.3	16/304	Banesc	70	27.5	10777	82395	754390	2265863	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	GEZIM	ISUFI	86411.4	1/123	Truall	90	0	10777	0	969930	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	KOZMA	QURKU	86421.4	2/99,2/100,2/101	Truall	597	0	10777	0	6433869	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	MAZAR	ISUFI	86421.4	7/36	Truall	23.8	0	10777	0	256493	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	SHIPETIM	ÇATO	86421.3	11/77	Truall	65	0	10777	0	700505	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	MERTIR	GJONI	86421.3	11/104	Truall	5	0	10777		53885	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	ANASTAS	PETKO	86411.3	19/141	Truall	52	0	10777	0	560404	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	RUZHIDI	IBRAHIMI	86421.4	3/58	Banesc+Truall	54	14	10777	82395	581958	1153530	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	JORGJI	MUKA	86421.4	5/197	Truall	335	0	10777	0	3610295	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	SHERIF	KASAJ	86411.4	3/87	Truall	110	0	10777	0	1185470	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	KOSTA	CILI	86421.3	8/178	Truall	5	0	10777	0	53885	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	HAXHEKO	PROI	86411.3	16/110	Truall	245	0	10777		2640365	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma					2112	483			22,758,222	32,880,166	
								VLERA TOTALE			55,638,388	Lekë

Shënim. Çmimi për qytetin e Sarandës për banesat 82395 lekë/m² është marrë nga ZVRPP-ja Sarandë dhe për truallin 10777 leke /m² sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.